**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-19-9093-5-3-6/C241**
**14 Nr. 1389/19**
**Dt. 12.12.2019**

# KONTRATË PUNE/SHËRBIMI

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PORORSITËSI)** , dhe

2. **NNP " Wenda "** me seli në **Vushtrri**, me **NRB: 80281714 e Nr. Fiskal: 600203939**, të cilën e përfaqëson **z. Kadri Selmani**, në tekstin e mëtejmë: **KRYESI I PUNËVE/ SHËRBIMEVE,**

janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: : **Ndërtimi i kanalizimit në fsh. Smrekonicë , L=404M'**, me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi Nr. | VU644 | 1 | 9 | 60 | 7 | 7 | 5 | 3 | 6 |
| Prokurimi Nr. | 644 | 1 | 9 | 1 | 5 | 8 | 5 | 3 | 6 |

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **ekzekutimi i punimeve në instalimin e kanalizimit fekal dhe punëve tjera në fsh. Smrekonicë, në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit. **Afati i fillimit të punëve është jo më gjatë se një ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës**, ndërsa ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se **12 ditë kalendarike pas datës së fillimit të ekzekutimit të Shërbimeve dhe / ose Punëve.**

1.3 Vendi i **ndërtimit të kanalizimit është në fsh. Smrekonicë.**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP[1] (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **9.475,48€ ( nëntmijkatërqindshtatdhjetepesë/48 Euro).**

**3.2 Mjetet për realizimin e projektit janë siguruar nga fondet, si vijon :**

[1] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

- **Shërbimi Korrektues i Kosovës, në shumë të përgjithshme prej ............... 5.666,93€, dhe**
- **Komuna e Vushtrrisë, në shumë të përgjithshme prej ........................... 3.808,55€**

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës **pas pranimit teknik të shërbimeve dhe / ose Punëve të ekzekutuara të konfirmuara nga Organi Mbikëqyrës. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Organi Mbikëqyrës do ti dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për punimet dhe / ose shërbimet e përfunduara dhe / ose pranuara.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e **punëve dhe / ose shërbimeve** duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni, **përmes Deklaratës me shkrim, do të mbetet valid për 12 muaj**, pas pranimit të **punëve dhe / ose shërbimeve.**

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **punëve dhe / ose shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.**

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik:**

**NNP " Wenda " – Vushtrri**

**Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë**

| **Emri:** | **Kadri Selmani** | **Emri:** | **Saranda Cakaj** |
|---|---|---|---|
| Pozita: | Pronar | Pozita: | Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | 12.12.2019 | Data: | 12.12.2019 |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G**
**Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 18, 8 apo 0, e jo në formatin ~~18% apo 8% apo 0%~~,**
**Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, çmimi duhet shkruar me dy decimale pasë presjes dhjetore**

| *Nr.* | *Përshkrimi i pozicioneve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* | *Çmimi për njësi pa TVSH* | *Norma e TVSH-së në %* | *Çmimi për njësi (me TVSh)-€* | *Totali (Pa TVSH)* | *TVSH* | *Totali (me TVSH)-€* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Punët Përgaditore** | | | | | | | | |
| 1 | Inqizimi gjeodezik trases se terenit verifikimi i gjendjes egzistuese punimi i profilit gjatësorë, identifikimi i sakte i pusetave para fillimit te punimeve, llogaria per ter gjatesin e trasës | m' | 404.00 | 0.08 | **18.00** | **0.10** | 34.24 | 6.16 | **40.40** |
| 2 | Prerja e drunjeve, shkurrave ngarkimi dhe transporti në vendin e caktur, Materjalet e shumta plastike te grombullhen ne paketime te veqanta dhe transportohen ne deponi legale, llogaria per gjate tere gjatesise se prrockes-trases | m' | 254.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 107.63 | 19.37 | **127.00** |
| | **Punët Tokësore** | | | | | | | | |
| 3 | Germimi dhe planifikimi rrjedhes natyrore ne forme trapezi të prrockes sipas përshkrimit b=2,5-2.2m ; h=1.70-2.8m , llogaria per gjate tere gjatesise se prrockes-trases , materiali I germuar largohet ne deponi | m' | 254.00 | 0.85 | **18.00** | **1.00** | 215.25 | 38.75 | **254.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **Gërmimi i kanalit sipas projektit për kolektorët kryesor në dheun e kat. III-IV më makinë apo me dorë me thellësi sipas projektit (h=1.20-2.5m) dhe më gjërësi sipas normave dhe standardeve, Llog. në m3** | | | | | | | | |
| 4.1 | Gërmimi me makineri 90% | $m^3$ | 363.60 | 0.76 | **18.00** | **0.90** | 277.32 | 49.92 | **327.24** |
| 4.2 | Gërmimi me dorë 10% | $m^3$ | 40.40 | 0.81 | **18.00** | **0.95** | 32.53 | 5.85 | **38.38** |
| 5 | Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit. Llog. në m1 te kanalit | m' | 404.00 | 0.21 | **18.00** | **0.25** | 85.59 | 15.41 | **101.00** |
| 6 | Largimi devijimi i ujërave siperfaqesore te prrockes dhe atyre nën tokësore me pompa adekuate gjatë hapjes së kanalit dhe instalimit të gypave (në llogari është marrë gjatësia e trasës e cila kalon nëpër prrockë). Llog në m1 | m' | 404.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 171.19 | 30.81 | **202.00** |
| 7 | Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktesi ±1cm. Llog. Në m1 të kanalit | m' | 404.00 | 0.17 | **18.00** | **0.20** | 68.47 | 12.33 | **80.80** |
| 8 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës se bute adekuate në fundin e kanalit, anash dhe mbi gyp. Rëra në fundin e kanalit vendoset me një trashesi min. t=10 cm, ndërsa mbi gyp min. t=10.0 cm. Llogaria në m3 | $m^3$ | 106.68 | 4.24 | **18.00** | **5.00** | 452.03 | 81.37 | **533.40** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Mbulimi i kanalit pas instalimit të gypit dhe mbeshtjelljës së tij me rërë, Mbulimi bëhet nga dheu i germuar dhe atë në shtresa t=30cm dhe me ngjeshje. Llog. m3 | $m^3$ | 297.32 | 1.44 | **18.00** | **1.70** | 428.34 | 77.10 | **505.44** |
| 10 | Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar (tepërt) në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës ne largesi deri në 5km. | $m^3$ | 106.68 | 0.68 | **18.00** | **0.80** | 72.33 | 13.02 | **85.34** |
| 11 | Germimi I gjere I dheut per hapjen e shtratit te ri te lumit ne drejtimin e rrjedhjes me gjatesi L=158 me dimensione te kanalit b=3.0m ndersa thellesia mesatare h=1.8-3.2 m, llogaria ne m3 te dheut te kanalit, fundi dhe anet e kanalit duhet te jene mir te planifikuara | $m^3$ | 1,042.80 | 0.81 | **18.00** | **0.95** | 839.54 | 151.12 | **990.66** |
| | **Punët montuese të gypave** | | | | | | | | |
| 12 | **Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE për kolektorët kryesor, para fillimit te punimeve te ketyre gypave duhet te sillet mostra dhe atestet per keto lloj gypash** | | | | | | | | |
| 12.1 | PESN8 Ø 400 | m' | 404.00 | 9.75 | **18.00** | **11.50** | 3,937.29 | 708.71 | **4,646.00** |
| | **Punët e Pusetave** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Ngjeshja e fundit të pusetave me ngjeshes adekuat, si dhe vendosja e zhavorit 0-32mm me ngjeshje, Llogaria në copë, pozicioni i germimit te pusetave eshte parapa ne pozicionin B.2.2 | copë | 10.10 | 12.71 | **18.00** | **15.00** | 128.39 | 23.11 | **151.50** |
| 14 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme ne puseta me betonarme C- 20/25 d=20cm ne logarin te merret edhe sasia e betonit per punimin e kinetave | m3 | 2.42 | 29.66 | **18.00** | **35.00** | 71.90 | 12.94 | **84.84** |
| 15 | Furnizimi, transporti dhe vendosja e armatures rrjetë Q335 në pllaken e poshtme të pusetës, Llog në m2 | m2 | 10.10 | 1.02 | **18.00** | **1.20** | 10.27 | 1.85 | **12.12** |
| 16 | Furnizimi transporti dhe montimi i gypave (për puseta) prej betonit Ø800mm gjatesia e ndryshueshme varesishte nga thellesia (elemente të parafabrikuara ). Llogaria në m1 | m' | 10.12 | 12.71 | **18.00** | **15.00** | 128.58 | 23.14 | **151.73** |
| 17 | Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø800/600/550mm (elemente të parafabrikuara). | copë | 10.10 | 10.17 | **18.00** | **12.00** | 102.71 | 18.49 | **121.20** |
| 18 | Furnizimi, punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton, armatura duhet te jete me lyrje antikorrozive. | copë | 50.50 | 1.53 | **18.00** | **1.80** | 77.03 | 13.87 | **90.90** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | Furnizimi, transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize me peshë mbajtëse T = 25 ton. Në çmim të llogaritet kapaku, korniza e gizes dhe betoni C-25/30 i përforcuar me armaturë. Llog. në copë | copë | 8.88 | 42.37 | **18.00** | **50.00** | 376.06 | 67.69 | **443.75** |
| 20 | Furnizimi me materjal , armimi dhe betonimi I kokës dalse në formen trapezi me diemnsione 1,20x1,60m' sipas projektit , në këtë pozcionë është përfshirë edhe punet e gërmimit planifikimit | $m^3$ | 6.56 | 25.42 | **18.00** | **30.00** | 166.78 | 30.02 | **196.80** |
| 21 | Furnizimi dhe punimi I kyqjeve invidualе ne puseta, punet perfshin hapjen dhe mbylljen e kanalit me gjatesi l=10 m gypin PEHD Ø200, reren , largimin e dheut te tepert dhe depertimin ne pusetë | copë | 6.00 | 29.66 | **18.00** | **35.00** | 177.97 | 32.03 | **210.00** |
| | **Punët Tjera** | | | | | | | | |
| 22 | Testimi i rrjetës së kanalizimit, ne prani te organit mbikqyres. Llogaria në m1 | m' | 404.00 | 0.08 | **18.00** | **0.10** | 34.24 | 6.16 | **40.40** |
| 23 | Pas perfundimit te punimeve te behet planifikimi i terenit, dhe per te gjitha materjalet te sillen atestet dhe kompletimi I dokumentaionit me projektin sipas egzekutimit | m' | 404.00 | 0.08 | **18.00** | **0.10** | 34.24 | 6.16 | **40.40** |
| **TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH :** | | | | | | | **8,029.92** | **1,445.39** | **9,475.30** |

**IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

| | |
|---|---|
| EMRI I OE: | NNP "WENDA" |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Kadri Selmani |
| NËNSHKRIMI: | |
| DATA: | 02.12.2019 |
| VULA: | |